Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.

b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.

c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Mallrat për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.

ç) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:

1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
2. Njoftimin e Kontrates;
3. Kriteret e Përzgjedhjes;

4. Specifikimet teknike, grafikun e lëvrimit dhe sasinë e kërkuar;
5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
7. Listat e Çmimeve të Artikujve.

d) Norma e fitimit e shprehur në vlerë absolute është si më poshtë

1	2	3
Nr	Përshkrimi i mallrave	Norma e fitimit

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 2.*(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)***LISTA E ÇMIMEVE TË ARTIKUJVE****Data:** _____**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:** _____**Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE):** _____**Monedha:** _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të rregullohen në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë artikujt në Formularin e Sasisë dhe grafikut për Mallrat duhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar në Listën përkatëse të Çmimeve për artikujt. Artikujt pa çmim do të konsiderohen si artikuj të paofruar dhe do të cojë në refuzimin e ofertës.

Lista e Çmimeve

<i>1</i>	<i>2</i>	<i>3</i>	<i>4</i>	<i>6</i>	
Artikulli	Përshkrimi i mallit	Sasia	çmimi per njësi	Çmimi total për artikull (3 x 4X)	
1.					
2.					
3.					
4					
	Çmimi total (Mallrat)				_____
Çmimi Neto pa TVSH					
TVSH (%)					

Çmimi total me TVSH:	
Emri i përfaqësuesit të ofertuesit Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 3.

[*Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik*]

[*Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve*]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [*Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor*]

Në emër të: [*Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar*]

* * *

Procedura e prokurimit [*lloji i procedurës*]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [*objekti*]

Publikimi (*nëse zbatohet*): Buletini i Njoftimeve Publike [*Data*] [*Numri*] / Nr. Referencës në faqen e APP-së

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [*emri i autoritetit kontraktor*] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [*njoftimin e kontratës*].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 4.

(Shtojcë për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit

Nënshkrimi**Vula****Shtojca 5.**

[*Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor*]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

SPECIFIKIME TEKNIKE

1. Kostum uniforme (xhakete, pantallona, këmbishë, kravatë, kapelë, këpucë).

Cvbnm



Xhaketa e kostumit të uniformës do të jetë **blu e errët**, perberja: 65% poliestër dhe 35% viskoze ($\pm 5\%$). Peshë: 270 ± 10 gr/m², me spaleta për vendosjen e shenjave të supit dhe katër kopsa. Ka katër xhepa me kapak (dy xhepa të vegjël në pjesën e gjoksit dhe dy xhepa të mëdhenj të poshtëm). Në krahun e majtë vendoset stema e bashkisë. Te jaka vendoset elementi kryesor i stemës së bashkisë. Xhaketa e uniformës për femra është e njëjtë përveç modelimit, i cili duhet të jetë për femra, me kopsat në anën e majtë.



Pantallonat, njëlloj me xhaketën ngjyrë **blu e errët**. Perberja: 65% poliester dhe 35% viskoze(\pm 5%),Pesha: 270 ± 10 gr/m².Pantallonat duhet të pajisen me dy xhepa të përparmë diagonal dhe me një xhep të pasmë. Konstruksioni i pantallonave për meshkuj duhet të jetë sipas modelit klasik me vijë hekurosjeje. Pantallonat për femra kanë konstruksion të njëjtë, përveç modelimit, i cili duhet të jetë për femra.



Garancia 2 vite

2.Xhup blu i errët në pjesën poshtë, shoqëruar me shirit të bardhë dhe të kaltër në formë kuadrati. Pjesa e sipërme është ngjyrë e kaltër. Mëngët janë ngjyrë blu e errët së bashku me jakën. Në krahun e majtë vendoset stema e bashkisë dhe në krahun e djathtë, poshtë shiritit shenja e gjoksit. Në pjesën e pasme vendoset mbishkrimi “POLICIA BASHKIAKE”.

Xhup dimeror , pjesa e sipërme të mos depertoje shiun dhe eren, të sigurojë mbrojtje të gjithanshme ndaj kushteve të motit. ,

Peshe 190 ± 10 gr/m², 100% poliester poliuretano, astar i brendshëm 100% polyester 120 ± 10 gr/m² me imbotiture; kapuc i levizshëm i cili mund të pershtatet lehtësisht dhe të kycet të ketë mundësi pershtatjeje;

Xhupi duhet të jetë blu në të errët.

Mbrojtje e gjithanshme ndaj kushteve të motit. Sipas normative SSH/EN 342:2017; SSH/EN ISO 20471:2013+A1:2016 klasi 2. SSH/EN 343:2019 klasi 3, ose ekuivalente, SSH/ EN ISO 13688/2013.
CERTIFIKIMI

Te jenë me logo “POLICIA BASHKIAKE” .



Garancia 2 vite

3.Pantallona verore : Pantallona ngjyrë blu e errët. Pantallonat duhet të pajisen me dy xhepa të përparmë diagonal dhe me një xhep të pasmë. Ky model shërben edhe për stërvitje. Perberja: 65% poliester dhe 35% pambuk ($\pm 5\%$),Pesha: 190 ± 10 gr/m² .



Garancia 1 vit

4 Pantallona dimerore: te jete e realizuar sipas modelit klasik dhe është i përbërë sipas elementave që vijojnë :

- Qemer
- Dy këmbë
- Katër xhepa

Qemer

Përgjatë qemerit janë të vënë 6 kalime, lartësi 5 cm dhe gjerësi 12 mm, me dritë të brendshme prej 5 cm, të forcuara mjaftueshëm nga rripi dhe trari lart në pjesën e jashtme dhe poshtë në pjesën e brendshme dhe të bërë me pelhurë dopio.

Xhepa

Janë katër, dy model francez të vëna përpara dhe dy të pasme :

- Xhepat anësorë : janë të pjërrta, të cojnë në qepjen e rripit, të pozicionuara rreth 3 cm nga qepja e fiankeve në pjesën e lartë, ndërsa në pjesën e poshtme janë të futura në qepjen e fiankeve. Hapja, e gjërë rreth 19 cm, është e forcuar në qepjet e jashtme dhe tranin.
- Xhepat e pasëm : janë horizontale dhe me dopio filet të vëna 7 cm larg qepjes qendrore, të largësisë të variueshme nga 13 në 14 nga baza e prerjes; në pjesën e poshtme të xhepit, dhe 1 cm larg nga fileti është e bërë një vrimë vertikale me pikë rreth 20 mm, xhepat e brendshem janë të realizuar në pëlhurë silesia
- Janë përshtatur nga brenda me një fintë dhe një kundër fintë moster e të njëjtës pëlhurë të pantallonave

Pantallonit duhet t'i sigurohet perthyerja permanente me hekurosje përpara të ekuilibruar për temperature. Perberja: 65% poliestër dhe 35% pambuk ($\pm 5\%$), Pështa: 240 ± 10 gr/m².

Garancia 1 vit

5. Këmishë me mëngë të shkurtra ngjyrë e kaltër. Këmisha në pjesën e supeve ka 2 spaleta për montimin e shenjave të supit. Mbyllja e këmishës bëhet me 7 kopsa të vogla. Në krahun e majtë vendoset stema e bashkisë. Në krahun e djathtë sipër vendoset shenja e gjoksit. Këmishapër femra është e njëjtë përveç modelimit, i cili duhet të jetë për femra me kopsat në anën e majtë. Cilësi e parë me përzjerje 33% pambuk dhe 67% poliestër ($\pm 3\%$).



LËNDA E PARË: Puplinë me përbërje: 65% pambuk dhe 35% poliester +/-3%.

- Masa: 110 gr/m2 +/-3gr.
- Thurja: Garniture.
- Ngjyra: Boje qelli
- Qëndrueshmëria në keputje në kg:
pak se 22. Në bazë jo me pak se 35, në ind jo me
- Qëndrueshmëria e ngjyrës: Shumë e mirë (nota 5)
- Dëndësia e fijeve në 10 cm: Në bazë 315 +/-6, Ind 214 +/-6%.
- Numri i fillit : 54/1.

Garancia 1 vit

6.Këmishë me mëngë të gjata ngjyrë e kaltër. Këmisha në pjesën e supeve ka 2 spaleta përmontimin e shenjave të supit. Mbyllja e këmishës bëhet me 7 kopsa të vogla. Në krahun e majtë vendoset stema e bashkisë. Në krahun e djathtë sipër vendoset shenja e gjoksit. Këmisha për femra është e njëjtë përveç modelimit, i cili duhet të jetë për femra me kopsat në anën e majtë.

- Fortesë mansheti për mëngët me kollaritje të plotë.-.Prodhoven me jakë të mbyllur.
- Numuri i fillit : në bazë 75/1-80/1;në ind 75/1-80/1.- Numurat e gjoksit 7 nga 44 – 56 .
- Dëndësia në 10 cm: nëbazë 450 ± 10 ; në ind 300 ± 10.
- Qëndrueshmëria kg : 70 –6 ;në ind 40 – 6 . –Thurje - garniturë
- Penj qepje 100 % poliestër me ngjyrën e tekstilit ose ngjyrë tjetër me ndryshim të pa përfilshëm. –Numurat e jakës:36,37-38,39-40,41-42,43-44,45-46,47-48,49-50.
- Frazelinë me ngjitje për forcimin e spalines, kapakëve të xhepave.

-Në gjoks ka dy xhepa pllak me kapak me përmasa 14x16 cm.



Garancia 1 vit

7.Kravata blu e errët, me një shirit të hollë të kaltër dhe gjerësi max. 7–8 cm.

- Materiali cilësi e parë, pëlhurë sintetike, 100 % poliestër.
- Ngjyra blu e errët.
- Gjatësia 500 ± 20 mm ;
- Me astar mëndafshi,importi,(blu i errët ose i zi),100% poliestër.
- Frazelinë për fortesë nga brënda.
- E lidhur në formë koke dhe në fund të jetë në formë trekëndëshi.
- Me llastik të lëvizshëm që kalon brënda kokës,dhe në të dy anët velkrof për t'u mbërthyer në qafë.
- Pesha e pëlhurës sintetike 190 ± 5 gr/m².

Garancia 1 vit



8.Kapelë tip sportive me ngjyrë blu e errët me stemën e bashkisë në mes dhe mbishkrimin "POLICIA BASHKIAKE".

Me strehe te gjate plastike e veshur me dokun e vet, me perforcim ne kupe, me rrip prapa per rregullimin e gjerësisë, ne balle shkruar me qendrisje me penj te bardhe ne forme harku "POLICIA BASHKIAKE" dhe poshte qepet sterna e Bashkise.

LËNDA E PARË : TEKSIL RIP STOP përbërje: 50% pambuk dhe 50% poliestër +/-3%.

- Masa: 220 gr/m2 +/-3gr.
- Ngjyra: Blu e eret
- Qëndrueshmëria në keputje në kg: Në bazë jo me pak se 35, në ind jo me pak se 22.
- Qëndrueshmëria e ngjyrës: Shumë e mirë (nota 5)
- Dëndësia e fijeve në 10 cm: Në bazë 315 +/-6, Ind 214 +/-6%.



Pamja anash

Pamja përpara

Pamja anash

Garancia 1 vit

9.EMBLEMË KRAHU

Shenja e krahut është në formë mburoje me përmasa 8 cm x 6 cm. Shenja përmban stemën e bashkisë dhe mbi të mbishkrimin "POLICIA BASHKIAKE". Kjo shenjë vendoset në krahun emajtë. Kjo shenjë është e njëjtë për drejtuesin, përgjegjësën e sektorit dhe punonjësën e Policisë Bashkiake.



Garancia 1 vit

10.Këpucë me qafa ngjyrë e zezë, me lidhëse. Këto shërbejnë edhe për stërvitje.

1. SYPRINA DHE INSERTET : Lëkurë viçi e plotë e zezë

2. AKSESORËT:

Filato – për faqen e nailonit titulli tex 30x2 për gjilpërë, për astar (spola) nailon titulli tex 40x2; me ngjyrë të njejtë me këpucën për qepjet e dukshme në siprinë, me ngjyrë të njejtë me atë të astarit për qepjet e dukshme në astar.

Filato – për qepje “blake” në nailon titulli tex 1.0;

Thumbat – prej hekuri të përdorur për montimin e thembrës.


Ngjitësit – duhet të jenë tip dhe cilësi nga më të mirët në treg, jo dëmtues dhe të përshtatshëm në përdorim.

Lidhëset– duhet të jenë prej pambuku merçerizues të tipit tub të lyer me ngjyrë të zezë, që nuk krijonë nyje me ekstremet plastike, të gjatësisë rreth 85 cm.



Garancia 1 vit

11.Këpuçë gjysma verore (për meshkuj e femra), ngjyrë e zezë, me lidhëse për punonjësit meshkuj dhe me takë për punonjëset femra.



Garancia 1 vit

12.Pulovër blu e errët golf me zinxhir.Pesha:320 ± 10 gr/m2. Perberja: 100% Poliester. Ngjyrosja: Nota 4. Ngjyra: Blu e errët.Ka përforcime doku në bërryla dhe supe, me spaleta doku. Në krahun e majtë vendoset stema e bashkisë. Në krahun e djathtë sipër vendoset shenja egjoksit.



Garancia 1 vit

13. Bluzë me mëngë të shkurtra e trikotuar, e hapur në mes dhe mbyllet përpara me tri kopsa të vogla. Pjesa poshtë është ngjyrë blu e errët së bashku me jakën, ndërsa pjesa sipër e kaltër. Në krahun e majtë vendoset stema e bashkisë, ndërsa përpara në krahun e djathtë sipër, vendoset shenja e gjoksit dhe poshtë saj mbishkrimi “POLICIA BASHKIAKE”. Ky mbishkrim është dhënë pjesën prapa. Bluza për femra është e njëjtë përveç modelimit, i cili duhet të jetë për femra me kopsat në anën e majtë.

- Materiali 50% pambuk 450 % polyester.
- Pesha 220 gr/m²
- Qendrueshmëria e ngjyres shumë e mirë (nota 5)
-

Ne pjesën e përparme të Bluzës të vendoset një velkroft i butë me përmasat 8.5 x 2.8 cm .



Garancia 1 vit

14.RRIP OPERACIONAL

Këto specifikime teknike, përcaktojnë kërkesat cilësore të prodhimit të Rripit të shërbimit, sintetik për Policinë Bashkiake.

Ka mekanizëm të veçantë për rregullim të lehtë të gjatësisë edhe pse ekzistojnë madhësi të vecanta të rripit nga M deri te 2XL. Këto rripa janë specifike për punonjësit e policisë, sepse në to mund të vihet këllëf për pistoletë, rezerva muncionesh, shkop , pranga ,radio dhe çdo gjë që ju duhet. Ka ngjyrë të zezë kështu që përshtatet lehtë me uniformën ose pajisjen që ka veshur polici.

Materialet që do të përdoren:

- Materiali tekstil – sintetik, cilësisë së parë, me thurje të dendur (nga tërheqja nuk zgjatohet).
- Astar velkrofi në gjysmën e gjatësisë fundore.
- Ngjyra : I zi.
- Gjatësia e përgjithëshme: 1350 (± 10 m / m).
- Gjerësia : 55 ÷ 60 m/m.
- Tokëza për mbërthim : femër – mashkull (metalike e kromuar ose plastike) në ngjyrë të zezë.
- Vega : dy copë të futura në rrip, me gjerësi 15 m/m, me material metalik i kromuar ose sintetik të thurur.

Ripi të jetë i kompletuar me aksesorët:

- Mbajtese e bllokut te gjobave.
- Këllëf për mbajtjen e prangave (hekurave lidhës).
- Unazë për mbajtjen e shkopit të gomës.
- Mbajtese e radios.

Garancia 1 vit

15.SHIRITA SINJALIZUES



Shiriti sinjalizues, te kete dimensionet 7.5 cmx100 mx0.03 mmi cili perdoret ne ne punime ne rrugë per te kufizuar zonat e punës. Materiali përbërës është PVC me fushe te bardhe te kete te stampuar stemen e Bashkise Durres, mbishkrimin Policia Bashkiake dhe ndalim kalimi me ngjyre bojeqielli

16.Kostum uniforme ceremonial (xhakete, kravatë, kapelë, këpucë, shiritat, dorezat, rrip mesi + rrip krahëqafë).

Xhaketa e kostumit të uniformës do të jetë **blu e errët**, Perberja: 65% poliestër dhe 35% viskoze(± 5%),Pesha: 270 ±10 gr/m², me spaleta për vendosjen e shenjave të supit dhe katër kopsa. Ka katër xhepa me kapak (dy xhepa të vegjël në pjesën e gjoksit dhe dyxhepa të mëdhenj të poshtëm). Te jaka vendoset elementi kryesor i stemës së bashkisë. Në krahun e majtë vendoset stema e bashkisë. Xhaketa e uniformës për femra është e njëjtë përveç modelimit, i cili duhet të jetë për femra, me kopsat në anën e majtë.



Pantallonat, njëllor me xhaketën ngjyrë **blu të errët**. Perberja: 65% poliestër dhe 35% viskoze(± 5%),Pesha: 270 ±10 gr/m². Pantallonat duhet të pajisen me dy xhepa të përpamë diagonal dhe me një xhep të pasmë. Konstruksioni i pantallonave për meshkuj duhet të jetë sipas modelit klasik me vijë hekurosjeje. Pantallonat për femra kanë konstruksion të njëjtë, përveç modelimit, i cili duhet të jetë për femra.



Kravata blu e errët, me një shirit të hollë të kaltër dhe gjerësi max. 7–8 cm.




Kapelë blu e errët, me stemën e bashkisë në qendër, shoqëruar me shirit të gërshetuar përpara. Shiriti ngjyrë ari është për drejtorin, shiriti ngjyrë argjendi për përgjegjës të sektorit dhe shiriti ngjyrë e kaltër për punonjës. Ka strehë plastike me ngjyrë të zezë.



Shiritat janë të gërshetuara. Shiriti ngjyrë ari është për drejtuesin, shiriti ngjyrë argjendi për përgjegjës të sektorit dhe shiriti ngjyrë e kaltër për punonjës.

Doreza të bardha;



Rrip mesi + rrip krahëqafë e bardhë, tokëz metalike katrore me stemën e bashkisë.



Garancia 4 vjet

17.ATLETE UNIFORME

Të jenë me përbërje të kombinuar lëkure të ndërthur me rrytë në masën 20-30%. Të kenë lidhëse të cilat kalojnë në vrima të përforcuara me tegela të rregullt me hap të njëjtë, pa grumbullime penjesh dhe me perçina. Këpucët (atletet), të jenë të përshtatshme për vrapim në terrene të hapura, pjesa që prek tokën të jetë prej gome të butë, ku të jetë stampuar dukshëm numri. Tabani nga brenda të jetë i trashë dhe poroz. Atletet të jenë ngjyra të ndryshme, të cilat do të përcaktohen në momentin e lidhjes së kontratës. Të paktohen në kuti kartoni të shkruara të dhënat, sipas kërkesave të mësipërme. Numri i këpucës duhet të jetë i dallueshëm.

Garancia 1 vit

18.ELEKTIK I THJESHTË DORE

Elektriku i dorës një aksesor i domozdoshëm për tu orientuar në errësirë.

- Tipi : Elektrik dore
- Fluksi i ndriçimit : 110 lm
- Lloji i llambave : LED
- Gjatësia max : 125/250m rreze shikimi
- Shkalla e mbrojtjes : IP44
- Përmasat : H24.6 cm

Garancia 1 vit

19. Jelek fosforeshent ngjyrë e verdhë me dy shirita të bardhë dhe të kaltër në formë kuadrati. Shiritat janë të vendosur horizontalisht. Në pjesën përpara në krahun e majtë vendoset mbishkrimi “POLICIA BASHKIAKE”, ndërsa në krahun e djathtë vendoset shenja e gjoksit.

Perberja: 100% polyester, me dukshmeri te larte, sipas standartit SSH/EN ISO 20471 klasi 2 .



Garancia 1 vit

20. XHUP FOSFORESHENT OPERACIONAL - KUNDRA SHIUT (Xhiboks)

- Këto specifikime teknike përcaktojnë kërkesat cilësore të prodhimit të Xhupit sintetik të policisë bashkiake.
- Realizohet në linjë industriale, në mbështetje të pamjes së jashtme të mostrës fizike (1 xhup, numur gjoksi 52, gjatësi trupore 170 ÷ 172 cm, prerja III)

Xhup dimeror , pjesa e sipërme te mos depertoje shiun dhe eren, te siguroje mbrojtje te gjithanshme ndaj kushteve te motit. ,

Peshe 190 ± 10 gr/m², 100% poliester poliuretano, astar i brendshem 100% polyester 120 ± 10 gr/m² me imbotiture; kapuc i levizshem i cili mund te pershtatet lehtesisht dhe te kycet te kete mundesi pershtatjeje;

Xhupi duhet te jete blu ne te erret.

Mbrojtje e gjithanshme ndaj kushteve te motit. Sipas normative SSH/EN 342:2017; SSH/EN ISO 20471:2013+A1:2016 klasi 2. SSH/EN 343:2019 klasi 3, ose ekuivalente, SSH/ EN ISO 13688/2013. CERTIFIKIMI

Te jene me logo “POLICIA BASHKIAKE” .

Garancia 1 vit

21.Numer identifikimi

Shenja e gjoksit është në formë drejtkëndëshi me përmasa 9 cm x 4 cm. Brenda shenjës vendoset stema e bashkisë dhe numri personal. Shenja vendoset në gjoks në krahun e djathtë. Kjo shenjë është e njëjtë për drejtuesin, përgjegjësën e sektorit dhe për punonjësën e Policisë Bashkiake.

Garancia 1 vit

22.PANTALLONA TE SHKURTRA

Tekstil, cilësi e parë 35% viskoz + 65% poliestër ($\pm 3\%$).

Pesha për $m^2 = 210 \pm 5$ gr.

Pantalloni për meshkuj është e realizuar sipas modelit klasik dhe është i përbërë sipas elementave që vijojnë :

- Qemer
- Dy këmbë
- Gjashte xhepa

Qemer

Përgjatë qemerit janë të vënë 6 kalime, lartësi 5 cm dhe gjerësi 12 mm, me dritë të brendshme prej 5 cm, të forcuar mjaftueshëm nga rripi dhe trari lart në pjesën e jashtme dhe poshtë në pjesën e brendshme dhe të bërë me pelhurë dopio.

Xhepa

Janë gjashte, dy model francez të vëna përpara dhe dy të pasme dhe dy në forme pllake me kapak në pjesën e kone pjesën anesore mbi gju:

- Xhepat anësorë : janë të pjërrta, të cojnë në qepjen e rripit, të pozicionuara rreth 3 cm nga qepja e fiankeve në pjesën e lartë, ndërsa në pjesën e poshtme janë të futura në qepjen e fiankeve. Hapja, e gjërë rreth 19 cm, është e forcuar në qepjet e jashtme dhe tranin.
- Xhepat e pasëm : janë horizontale dhe me dopio filet të vëna 7 cm larg qepjes qendrore, të largësisë të variueshme nga 13 në 14 nga baza e prerjes; në pjesën e poshtme të xhepit, dhe 1 cm larg nga fileti është e bërë një vrimë vertikale me pikë rreth 20 mm, xhepat e brendshem janë të realizuar në pëlhurë Silesia.
- Xhepat mbi gjurin anesor ne forme pllake me kapak me nje vrime vertikale pikë rreth 20 mm e cila mberthet me nje kopse plastike .
- Janë përshtatur nga brenda me një fintë dhe një kundër fintë moster e të njëjtës pëlhurë të pantallonave

Garancia 1 vit

23. Shenja Supit

Shenjat e supit ngjyrë blu të errët (1 palë) janë në formë spaleti me përmasa 14 cm x 5 cm. Kjo shenjë ka elementin dallues të stemës së bashkisë, shoqëruar me shirita. Shenja me tre shirita ngjyrë ari për drejtorin, me dy shirita ngjyrë argjendi për përgjegjësin e sektorit dhe me një shirittë kaltër për punonjësin.

- Dok i cilësisë së parë
- Pesha $120 \pm 5 \text{gr/m}^2$



Garancia 1 vit

24. PRANGA

Hekurat lidhëse (prangat) të jenë manovrueshme për përdorim të shpejtë, të jenë të pajisura me dy çelësa bllokimi, të sigurohen me bllokues të dyfishtë, dhe forca e hapjes të jetë 200 kg.

Hekurat lidhëse (prangat) të jenë të pajisura me këllëf me ngjyrë të zezë me mbajtëse për tu vendosur në rrip.

Përmasat

1. Gjatësia e përgjithëshme..... 190 deri 200 mm
2. Trashësia e fletes dyfishe 2 + 05 mm
3. Trashësia e fletes me dhëmbeza..... 4 + 05 mm
4. Pësia..... 330+ 10 gr.
5. Perimetri min. i zones se shterngimit... 160 + 5 mm
6. Perimetri max. i zones se shterngimit... 200 + 5 mm

Materiali

1. Çelik me ngjyrë metalizato

Masat e sigurimit

1. Prangat të sigurohet me çelës
2. Pranga te jete e pajisur me siguresse te dyfishte bllokimi
3. Forca e hapjes200kg
4. Prangat te jene te pajisura me dy kopje celesi
5. Tipi i bashkimit me menteshe

Mbajtëse prangash

1. Ngjyra.....E zezë
2. Të jetë e pajisur me mbajtëse për tu vendosur në rrip.

Garancia 1 vit

25.SHKOPINJ GOME

Jane te perbere nga gome e presuar me diameter 3 cm. Gjatesia e shkopit te gomes eshte 59.5 cm. Larg nga njera ane e shkopit per 43.5 cm dhe nga ana tjeter e shkopit per 16 cm (ne aks) eshte doreza me te njejtin diameter me gjatesi 14 cm. Doreza ne maje, ka nje koke me diameter 5 cm ne forme sferike.

Garancia 1 vit

26.DRYN

Te jete prodhuar nga nje material shume rezistent me celik te trajtuar ne disa etapa per ta bere shume te qendrueshem ndaj kushteve klimaterike.

Me permasa 40mmx35mm me bosht të lëvizshëm. Me 3 kopje çelsash.

- Ngjyra : Bronze
- Njesia : PC
- Materiali : Çelik/bronz

Garancia 1 vit

27.TABELA SINJALIZUESE

Te jete e ndertuar prej materiali plastik te bardhe me mbishkrimin Policia Bashkiake.

Me permasa : gjatesia 44 cm me diameter 15.5 cm.

Garancia 1 vit

28. BILBIL

Te jete i ndertuar nga metal i një cilësie të lartë, me rrip përbërë nga material nailoni. Te kete nje tingull të lartë e të përshtatshëm per tu degjuar dhe orientuar mjetet ne trafik.

Garancia 1 vit

29. Pelerine shiu

Pelerine shiu me shirita reflektive duke përdorur pëlhurë të lehtë, kjo pelerinë është plotësisht i papërshkueshëm nga uji, gjithashtu përmban një kapuç të ambalazhuar, xhepa për ruajtje të

sigurt, si dhe unaza dhe carje shpinën e pasme për të shtuar ajrosjen.

Pëlhurë e lehtë ujëduruese me qepje të izoluara për të ndaluar penetrimin e ujit

Qepje hermetike me shirit për mbrojtje më të madhe

Shirit reflektues për më shumë dukshmëri

Hapje me zinxhire para

2 xhepa për hapsirë të sigurtë

Kapuç që paloset nën jakë

Mëngë elastike nga brenda

Vrima dhe hapje mbrapa për ventilim dhe rehati

Sipërfaqja e pëlhurës është ekstremisht ujë resistuese, duke e shpërndarë ujin nga sipërfaqja e pëlhurës.

Të ketë logot e autoritetit para majtas, në shpinë dhe mëngën e majtë.

Përmbajtja 100% Poliestër, e Veshur me PVC 210g

Ngjyra/Fit/Size blu e errët/ jeshile erret Nr. S - 3XL

Artikulli duhet të jetë sipas Standarteve SSH EN ISO 343:2019 CLASS 3.1 ose ekuivalente,

CERTIFIKIMI

Grupi i Specifikimeve Teknike

Shtojca 6

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT

Sasia e mallit që kërkohet:

Afatet e lëvrim:

Artikulli	Përshkrimi	Shuma	Destinacioni	Periudha e dorëzimit

Shtojca 7

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;
- dh) Operatori Ekonomik nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) Operatori Ekonomik ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) Operatori Ekonomik nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) Operatori Ekonomik ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) Operatori Ekonomik ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) Operatori Ekonomik kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfutur fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaësuesi, përçindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.1.1 **2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):** me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8. Te kete te perfshire ne objektin e veprimtarise se shoqerise (QKB) tregtimin e mallrave objekt te kesaj kontrate.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare **2021, 2022, 2023**, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël **se vlera e fondit limit qe prokurohet.**

2.2.2 Kopje të çertifikuara të bilanceve të 3 (*tre*) viteve të fundit (**2021, 2022, 2023**), të paraqitura në Administratën Tatimore dhe të konfirmuara prej tyre. Nëse operatori ekonomik ofertues është në kushtet e parashikuara nga neni 41, pika "c", e ligjit nr.10091 date 5.3.2009 "*Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit te ekspertit kontabel te regjistruar dhe te kontabilistit te miratuar*" i ndryshuar, atëherë secili bilanc duhet të shoqerohet me akt-ekspertizen e kryer nga eksperti kontabel.

Kjo kërkesë për kualifikim, konsiderohet e përmbushur nëse në 2 (*dy*) bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga secili anëtar i bashkimit.

2.2.3 Vërtetim për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin **2022 - 2023**, prane njesive vendore ku operatori ekonomik ushtron apo ka ushtruar aktivitetin, sipas ekstraktit të QKB, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Furnizime të së njëjtes natyre në një vlerë 40% të fondit limit, që prokurohet të realizuara (nga subjekti juaj) në 3 vitet e fundit. Kjo do të vërtetohet me dokumentat e mëposhtme.

- Për kontrata me institucionet shtetërore duhet të paraqitet kontrata dhe vërtetim realizimi ose faturat tatimore të shitjes, ndërsa furnizimet me subjektet private duhet të jenë të shoqëruara me fatura tatimore shitje të *konfirmuara nga bleresi dhe shites*, ku të përcaktohen qarte, sasitë, vlerat, nr dhe data e fatures.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të disponojë certifikatat e mëposhtme në lidhje me mallrat objekt prokurimi të vlefshme në momentin e hapjes së ofertave: Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë certifikatat e lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga organizmi kombëtar i akreditimit DPA, ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, të jenë të vlefshme, e që kanë lidhje me objektin e kontratës, si më poshtë: a) ISO 9001-2015 (ose e përditësuar) mbi sistemin e menaxhimit të cilësisë Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zërave që do të marrë përsipër të realizojë referuar akt-marrëveshjes

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të deklarojë nëse është prodhues ose tregëtues i autorizuar nga prodhuesi për artikujt për këtë objekt prokurimi. Në rast se ofertuesi nuk është prodhues duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi/ distributori i autorizuar i mallrave dhe të vërtetohet lidhja midis tyre (ofertues-distributor-prodhues) duke paraqitur kontratë furnizimi ose letër angazhimi/ akt-marreveshje (ose ekuivalent

2.3.4 Operatori duhet të ketë në pronësi ose në përdorim kundrejt kontratave perkatëse të noterizuara ambjent të përshtatshme për magazinimin e produkteve objekt prokurimi, për këtë qëllim operatori duhet të deklarojë vendodhjen e mallit dhe gjendjen aktuale të mallit që kërkohet, në mënyrë që të mund të verifikohet nga AK-ja.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të paraqesë si pjesë të ofertës teknike mostrat/ kampionet e artikujve që kërkohen të prokurohen, të përcaktuar në DST në përputhje me specifikimet teknike, si më poshtë: a) Operatorët ekonomik detyrimisht duhet të paraqesin nga një mostër fizike për objektet e uniformës (produkt të gatshëm) që do të prokurohen që përfshin të gjitha detajet, llojin

e materialit dhe pjesëve përbërëse të tyre, punimin dhe përmasat, në përputhje me specifikimet teknike të materialeve përbërëse të produktit referuar detajeve në shtojcën 5. b) Mostrat e paraqitura duhet të kenë të trupëzuar një etiketë të qepur, e cila të përmbajë: mostër “emri i artikullit” datën e zhvillimit të tenderit, emrin e prodhuesit/ofertuesit, nënshkrimin dhe vulën e operatorit ekonomik, të identifikueshme me numrin rendor përkatës në etiketë (sipas numrit rendor të tabelave (psh:Nr.1- Këmishë me mëngë të gjata, referuar preventivit/ shtojcës 2). c) Mostrat do të paraqiten në datën dhe orën e hapjes së ofertave pranë Autoritetit Kontraktor Drejtoria e Prokurimeve, Bashkia Rrogozhine, me Adresa: Bashkia Rrogozhinë, Lagja Nr. 1, Rruga e Kavajës, Blloku “12 Shtatori”. Mungesa e mostrës dhe e lëndës së parë që shoqëron ato është kusht s’kualifikues. Mosparaqitja e mostrave sipas kërkesave të mësipërme përbën kusht s’kualifikimi për vazhdimin e procedurave. Autoriteti kontraktor kur vëren dyshime i lind e drejta të verifikojë, të kërkojë analizat e nevojshme laboratorike nëse do të shihet e arsyeshme. Mospajtueshmëria përbën kusht s’kualifikimi.

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të beje dorezimin e mallit ne magazinën e Bashkise Rrogozhine, sipas preventivit dhe grafikut, qe do i bashkalidhet DST-ve.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Shtojca 8*(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)***FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT**

Unë i nënshkruari _____ në cilësinë e _____ të operatorit ekonomik
 _____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik

Identifikimi	Përgjigjja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE)	-----
Numri NIPT/et:	-----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	----- --
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	----- -
E-mail:	----- -----

B: DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- Informacione për nënkontraktorin**

Emri i nënkontraktorit të propozuar	NIPT –i	Përqindja e nënkontraktimit	Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t'u nënkontraktuar

- Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik**

Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et

Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata
<p>Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>
<p>Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>

Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:

etj.

nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë të dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.

Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së.

Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përfshiruar nga e drejta për të përfutur fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

B: DEKLARATA

Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura

